

FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS

RREGULLORE **PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË** **KOSOVËS**

Shkurt 2014

RREGULLORE
PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË
KOSOVËS

Neni 1.

Me këtë Rregullore vërtetohet mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura në garat e pingpongut, nga e cila del edhe vlerësimi i suksesshmërisë së përgjithshme të garuesve në formë të ranglistës.

Neni 2.

Suksesshmëria e tërësishme e garave vërtetohet në fund të stinorit gaarues-rangimi për tërë vitin. Po ashtu vërtetohet edhe rangimi aktual pas çdo gare që pikëzohet gjatë stinorit garues.

Neni 3.

Ranglistat bëhen për të seniorë, seniore, juniorë, junior, kadetë kadete, minikadetë dhe minikadete. Me rastin e vërtetimit të pozitës në ranglistë merren parasysh vetëm rezultatet e arritura në kategorinë e caktuar.

Neni 4.

Në fillim të stinorit garues, Komisioni profesional i FPPK-së përcakton garat të cilat do të pikëzohen për ranglistë në stinorin vijues.

Neni 5.

Vlefshmëria e rezultateve sportive shprehet në pikë. Pikët ndahen në bazë të fitoreve individuale, si dhe për plasmanin e arritur, sipas kritereve të vërtetuara me këtë Rregullore.

Neni 6.

Ranglistat, sipas të cilave pikëzohen fitoret vetjake, i renditin lojtarët në shtatë kategori:

Kategoria I	vendi 1-2 në ranglistën e FPPK-së
Kategoria II	vendi 3-4
Kategoria III	vendi 5-8.
Kategoria IV	vendi 9-16
Kategoria V	vendi 17-32.
Kategoria VI	vendi 33-64.
Kategoria VII	të tjerët.

Për lojtarët e huaj të cilët luajnë në klubet tona, si dhe për lojtarët tanë që luajnë në klubet e huaja, rangimin e caktojnë trajnerët e përzgjedhjeve.

Neni 7.

Ranglistat e FPPK-së bëhen vetëm për lojtarët dhe lojtaret që janë të regjistruara në FPPK.

Neni 8.

Vërejtje: Neni 8 **nuk** do të aplikohet menjëherë për shkak të mungesës së programit perkates për momentin. Ky nen do të shqyrtohet nga Kuvendi në baza vjetore dhe Kuvendi do të marrë vendim të veçantë për hyqjen në fuqi të tij. Mbetet obligim i FPPK që deri atëherë të sigurojnë nje program qe do te mundsonet llogaritjen e ranglistes sa më të përafërta me këto nene.

Në të gjitha garat pikëzuese, përveç pikëve që fitohen sipas tabelës 1 e cila është paraqitur në fund të kësaj rregullorje, lojtarët për çdo fitore ndaj lojtarit të

Kategoria I	fitojnë 25 pikë
Kategoria II	fitojnë 20 pikë
Kategoria III	fitojnë 15 pikë
Kategoria IV	fitojnë 10 pikë
Kategoria V	fitojnë 05 pikë
Kategoria VI	fitojnë 03 pikë.
Kategoria VII	fitojnë 01 pikë

Neni 9.

Nëse në një garë në konkurrencën e mashkujve paraqiten më pak se 32 pjesëmarrës, për plasman nën vendin e 16-të lojtarët fitojnë pikë në lartësi prej 50%. Në konkurrencën e femrave nëse paraqiten më pak se 16 pjesëmarrëse për plasman nën vendin 8 lojtaret fitojnë pikë në lartësi prej 50%.

Nese garuesi e fiton lojen per shkak te mungeses se kundershhtarit, si i fiton 50% te pikeve te parapara sipas tabelës 1, per ate nivel ne rast se peson humbje ne nivelin tjetër

Neni 10.

Pikët e fituara në kategorinë më të lartë vlejnjë edhe për kategorinë më të ulët, por jo edhe anasjelltas (shembull: juniori që merr pikë në kategorinë e seniorëve i llogariten edhe në listën e juniorëve).

Neni 11.

Garat të cilat pikëzohen për ranglistë në kategorinë e seniorëve-eve, juniorëve-eve dhe kadetëve-eve janë:

- Kampionati individual i Kosovës
- Turnetë e pranuar dhe mbështetura nga FPPK
- Turnetë e ftuara
- Top-K turnetë

Neni 12.

Pikët mbrojtëse mund të ipen vetëm në rastet kur lojtari nuk paraqitet në garë për shkak të paraqitjes për kombëtare, pasi që trajneri i përzgjedhjes e ka bërë njoftimin më parë. Në

atë rast lojtari merr pikët mbrojtëse sikur edhe lojtari që e ka fituar vendin e njëjtë në turneun përkatës, sipas vendit të tij në ranglistë.

Neni 13.

Nëse lojtarët në turne nuk mund të fitojnë asnjë ndeshje në grupe do të fitojnë 3 pikë për pjesëmarrje. (P) Lojtarët që fitojnë ndonjë lojë në grup, po jo mjaftueshëm për të kaluar grupin fitojnë 5 pikë për fitore në grup (FG).

Neni 14.

Me propozimin e Komisionit profesional, ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i bënë Bordi i FPPK-së.

Neni 15.

Tabela për pikëzimin nga turnete

TURNET	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	
	1	2	03-4	5-8	9-16	17-32	33-64	65-128	FG	P	
	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	Pike	
1	Turneu "Dita e Pavaresise së Kosovës"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
2	Turneu Nderkombetar "Adem Jashari"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
3	Turneu Memorial "Ilir Lushtaku"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
4	Kampionati individual per Senior dhe Seniore 2012	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
5	Turneu "Dita e Kombesise Turke"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
6	Turneu Memorial "Ahmet Hoxha"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
7	Turneu "Lidhja e Prizrenit"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
8	Turneu "Dita e Çlirimit te Prishtines"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
9	Turneu Memorial "Bedri Ajeti"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
10	Turneu "Kosova OPEN 2012"	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3
11	Turneu "Dita e flamurit kombetare" Senior	200	150	120	80	40	20	5	5	5	3

12	Turneu "TOP 8" dhe "TOP 12"	200	150	120	80	40	20	10	5	5	3
13	Turneu "Kosova OPEN 2012"	200	150	120	80	40	20	10	5	5	3
14	Turneu "Dita e flamurit kombetare" Senior	200	150	120	80	40	20	10	5	5	3
15	Turneu "TOP 8" dhe "TOP 12"	1	2	3	4	5	6	7	8		
		250	200	150	120	100	90	70	60		
		9	10	11	12						
		50	40	30	20						

Tabela per pikezim nga garat ekipore

Kategoria	Fitore	Humbje
Superliga	6	2
Liga e pare	3	1
Liga e juniorve	6	2

Tabela per pikezim ne garat jashte Kosoves eshte ne pergaditje nga komisioni, dhe posa te perfundohet do I shtohet kesaj rregullorje me vendim te Bordit.

Neni 16.

Ndryshimet e kesaj Rregulloreje jane miratuar ne mbledhjen e Bordit te FPPK-se te mbajtur me 10.02.2014 dhe hyn ne fuqi menjehere.

Kryetari i FPPK
Nehat Citaku